

AKT NORMATIV
Nr.4, datë 24.9.2009

**PËR DËRGIMIN E NJË TOGE MJEKËSORE, TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË KABUL, AFGANISTAN**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes,
Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin e një toge mjekësore, prej 20 (njëzet) vetash, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, në Kabul, Afganistan.

Neni 2

Misioni i autorizuar i togës mjekësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë mbështetja mjekësore, në operacionin ISAF të forcave pjesëmarrëse, nën komandën e zonës së Kabulit, përgjegjësi e palës turke.

Neni 3

Toga mjekësore do të veprojë në përbërje të njesisë speciale shëndetësore të Kamp Dogan Rol-2 dhe do të kryejë këto detyra:

a) Mbështetje mjekësore të forcave pjesëmarrëse në operacion, nën komandën turke, në Kabul, Afganistan.

b) Mbështetje mjekësore të strukturave të bashkëpunimit civilo-ushtarak (CIMIC), që do të dalin në terren në ndihmë të popullsisë civile, vendore, për skanimin shëndetësor të zonës, brenda rajonit të Kabulit.

Neni 4

Kohëzgjatja e misionit të togës mjekësore do të jetë 1 (një) vit.

Neni 5

Ushtarakët, që do të marrin pjesë në këtë mision, për çdo ditë qëndrimi, veç pagës mujore, do të marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, të njëjtë me atë të ushtarakëve, që dërgohen në mision, në përputhje me ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”, të ndryshuar.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Efektet financiare të togës mjekësore që do të shërbejë në ISAF 2009-2010
000/lekë

KABUL	Nr. Pers.	Paga ditore(\$)	Paga vjetore	Kursi	Kosto për 3 muaj	Kosto vjetore
Shpërblimi ditor	20	60	432,000	100	10,800	43,200
Sigurimi i jetës në (lekë)	20	0,563	4,054		1,013	4,054
Shuma						47,254
Shpenzime të tjera						
Materiale shëndetësore (vaksina, barna, materiale mjekimi dhe pajisje)	20	0,097			175	698
Transport strategjik të sëmurësh	3-4 vetë				2,200	8,600
TOTALI					2,375	56,552